

VENDIM
Nr.55, datë 26.1.2011

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOZHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2011, në njësitë e qeverisjes vendore, është 1146 punonjës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Përgjashtimisht, për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, për punonjësit e Institutit të Statistikave, të cilët do të merren me anketimin e forcave të punës, për 5 (pesë) punonjësit arkivistë, në aparatet e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për 5 (pesë) punonjësit në sektorin e pagesave dhe të dëmshpërblimeve, në Ministrinë e Financave, nuk zbatohet pika 3 e vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe veprimtarive sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

3. Përgjashtimisht, për punonjësit e kontraktuar nga Instituti i Statistikave, të cilët do të merren me regjistrimin e popullsisë, miratimi i numrit të tyre, afatet kohore dhe të tjera specifitime të përcaktohen nëpërmjet një udhëzimi të përbashkët ndërmjet INSTAT-it dhe Ministrisë së Financave

4. Përgjashtimisht, për Qendrat e Transferimit të Teknologjisë, në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për shkak të veçorisë së punës, pagesa e punonjësve të kontraktuar përllëgaritet sipas volumit të punës së kryer.

5. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2011, të njësive të qeverisjes qendrore. Për ALUIZNI-n, QTTB-të dhe Shtëpinë e Pushimit, Durrës, efektet financiare përballohen vetëm nga të ardhurat e vetë institucionit. Efektet financiare për pozicionet e kontraktuara për periudhën kohore vjetore fillojnë më 1 janar 2011.

6. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë me hollësi numrin e punonjësve sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi, brenda kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe veprimtarive sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare	Muajt
3	Këshilli i Ministrave	3			
	Aparati	3	Punonjës për arkiv - protokollin	5 orë/ditë	vjetorë
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	27			
	Aparati i Ministrisë	5	Punonjës për arkiv-protokollin	8 orë/ditë	vjetorë
	Aparati i Ministrisë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetorë
	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	5	Punonjës mbështetës	3-4 orë/ditë	vjetorë
	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	10	Roje objekti	8 orë/ditë	5 muaj
	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	3	Teknik gjeolog	4 orë/ditë	vjetorë
	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	1	Punëtor (sondist)	4 orë/ditë	vjetorë
	Qendra Kombëtare e Regjistrimit	2	Operatorë	8 orë/ditë	6 muaj

05	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit, Mbrojtjes së Konsumatorit	159			
	QTTB-në F.Krujë/Lushnjë/Shkodër/Vlorë/Korçë	144	Punëtorë blegtorie/fushë/mekanizator/ roje e bazës eksperimentale		
	Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve	12	Punëtorë fushë	4 orë/ditë	vjetorë
	Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve	1	Teknikë	4 orë/ditë	vjetorë
	Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve	2	Teknikë	4 orë/ditë	vjetorë
06	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	301			
	ALUIZNI	300	Specialistë/ ndihmësspecialistë	8 orë/ditë	vjetorë
	Instituti i Transportit	1	sanitar	3 orë/ditë	vjetorë
10	Ministria e Financave	14			
	Sektori i Pagesave të Dëmshpërblimeve	4	Specialistë	8 orë/ditë	vjetorë
	Sektori i Pagesave të Dëmshpërblimeve	1	Arkivist	8 orë/ditë	vjetorë
	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve/dega e thesarit Tiranë	1	Roje	6 orë/ditë	vjetorë
	Degët e thesarit	7	Sanitarë	deri 3 orë/ditë	vjetorë
	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe e Kontraktimeve	1	Sanitarë	deri 3 orë/ditë	vjetorë
11	Ministria e Arsimit	103			
	DAR-të në rrethe	13	Pastrues	4 orë/ditë	9 muaj
	ZAR-të në rrethe	25	Pastrues	3 orë/ditë	9 muaj
	Agjencia Kombëtare e Provimeve	1	Pastrues	4 orë/ditë	vjetorë
	Instituti i Zhvillimit të Arsimit	1	Pastrues	4 orë/ditë	vjetorë
	Agjencia Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional	1	Pastrues	4 orë/ditë	vjetorë
	Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë	1	Pastrues	2 orë/ditë	vjetorë
	Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parauniversitar	1	Pastrues	4 orë/ditë	vjetorë
	Instituti i Arkeologjisë	60	Punëtorë gërmimi	8 orë/ditë	6-mujor
13	Ministria e Shëndetësisë	8			
	Spitali Psikiatrik Elbasan	3	Kaldajistë	8 orë/ditë	janar-mars nëntor-dhjetor
	DSHP-ja Korçë	1	Kaldajistë	8 orë/ditë	janar-mars nëntor-dhjetor
	DSH-ja Korçë	1	Punëtorë mirëmbajtje	4 orë/ditë	vjetorë
	DSHP-ja Korçë	1	Operatorë	4 orë/ditë	vjetorë
	ASHR-ja Tiranë	2	Punëtorë mirëmbajtje	4 orë/ditë	mars-dhjetor
14	Ministria e Drejtësisë	6			
	Aparati i Ministrisë	5	Fotokopistë	8 orë/ditë	6-mujor
	Drejtoria e Shërbimit të Provës	1	Sanitar	3 orë/ditë	vjetorë
16	Ministria e Brendshme	100			
	Shtëpia e Pushimit Durrës	4	Kuzhinier	8 orë/ditë	1.5.11-30.11
	Shtëpia e Pushimit Durrës	4	Ndihmëskuzhinier	8 orë/ditë	1.6.11-30.11
	Shtëpia e Pushimit Durrës	25	Kamerierë	8 orë/ditë	1.6.11-30.11
	Shtëpia e Pushimit Durrës	9	Punëtorë restoranti	8 orë/ditë	1.6.11-30.11
	Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Teknik	8 orë/ditë	1.6.11-30.11
	Shtëpia e Pushimit Durrës	6	Receptionistë	8 orë/ditë	1.6.11-30.11
	Shtëpia e Pushimit Durrës	11	Punëtorë gjelbërimi	8 orë/ditë	1.6.11-30.11
	Shtëpia e Pushimit Durrës	10	Punëtorë kuzhine	8 orë/ditë	1.6.11-30.11
	Shtëpia e Pushimit Durrës	25	Punëtorë hoteli	8 orë/ditë	1.6.11-30.11
	Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Elektricitist	8 orë/ditë	1.6.11-30.11
	Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Hidraulik	8 orë/ditë	1.6.11-30.11
	Shtëpia e Pushimit Durrës	3	Lavanteri	8 orë/ditë	1.6.11-30.11
28	Prokuroria e Përgjithshme	2			
	Prokuroria Durrës	1	Pastruese	4 orë/ditë	1 shkurt-31 dhjetor
	Prokuroria e Apelit për Krimet e Rënda	1	Pastruese	4 orë/ditë	1 shkurt-31 dhjetor
50	Instituti i Statistikës	422			
	Instituti i Statistikës	368	Anketues të ndërmarrjeve/të tregtisë me pakicë/indeks çmimesh/ndërmarrje të reja	8 orë/ditë	4 muaj
	Instituti i Statistikës	3	Kontrollorë	8 orë/ditë	4 muaj

	Instituti i Statistikës	45	Anketues të forcave të punës	8 orë/ditë	vjetorë
	Instituti i Statistikës	6	Operatorë	8 orë/ditë	vjetorë
87	Agjencia e Mbështetjes për Shoqërinë Civile	1			
	Agjencia e Mbështetjes për Shoqërinë Civile	1	Specialist finance	8 orë/ditë	6 muaj
	Total numri i punonjësve	1146			